



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12.4.2023

Nr: 341

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. ALI HEKURAN GJETA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK
BULQIZË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "ALEANCA PROGRESISTE LZHK"**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ali Hekuran Gjeta, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK"

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5, 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Data: 12.4.2023 Nr: 341
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ali Hekuran Gjeta, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK"

Me vendim të KZAZ-së, z. Ali Hekuran Gjeta është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë Bulqizë, i mbështetur nga Partia “Aleanca Progresiste LZHK”.

Për këtë kandidat në datën 02.04.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik DI-LZHK-18967. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ, DPB informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ali Hekuran Gjeta, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitete të mëparshme, konkretisht rubrika e emrit, nga Auran ndryshuar në Ali.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 1 “A jeni denuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Gjykata e Barit. Burgim 6 muaj për periudhën 27.01.2011-27.06.2011. Expulx”
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Torino për 7 muaj. Arsyja emigrimi”.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Ali Hekuran Gjeta, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak Bulqizë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK” dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI